



**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2004 DATË 1 SHTATOR 2004

PËR

ZBATIMIN E TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në emër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së cilës i janë transferuar kompetencat e Autoritetit Qendror Fiskal në fillim të vitit 2003, në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/11 të datës 31 Maj 2001 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar në Kosovë (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/41 të datës 31 Dhjetor 2001, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/17 e datës 1 Gusht 2002, dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/xx e datës xx Gusht 2004).

Nxjerrin Udhëzimin Administrativ te mëposhtem:

Neni 1

Konsideratë

- 1.1 Në lidhje me Nenin 1.3 të Rregullores, “Konsideratë” nënkupton një pagesë, një akt a ndonjë shtyrje pagese në lidhje me furnizimin e mallrave apo shërbimeve, dhe do të përfshijë një shumë që është e pagueshme, apo mallrat e pranuar në një transaksion barter (mall-mall).
- 1.2 Në një transaksion barter në mes të dy personave të regjistruar, ku mallrat apo shërbimet janë marre nga pranuesi dhe konsiderata përmban mallra apo shërbime të marra nga furnizuesi për shfrytëzim ekskluziv në veprimtaritë komerciale, vlera e konsideratës do të gjykohet të jetë zero.
- 1.3 Në një transaksion barter në mes të një personi të regjistruar dhe një personi të paregjistruar transferi i mallrave apo shërbimeve nga personi i regjistruar për personin e paregjistruar do të gjykohet si i bërë për konsiderate. Vlera e tatueshme e transaksionit barter do të jetë vlerë e hapur e tregut për mallrat apo shërbimet të dhëna për këmbim.

Neni 2

Blerje e Përrjashtuar

- 2.1 Në lidhje me Nenin 1.8 të Rregullores, “Blerje e Përrjashtuar” nënkupton një import, Hyrje nga RFJ apo blerje brenda vendit për të cilën nuk paguhet tatimi mbi vlerën e shtuar nga perfituesi i mallit a shërbimit.
- 2.2 Në lidhje me nenet 11(d) dhe (e) të Rregullores, importet, Hyrje nga RFJ apo blerje brenda vendit të kryera nga Zyrat e Ndërlidhjes, Kombet e Bashkuara apo organet e tij përfshirë UNMIK-un, KFOR-in, Bankën Botërore, Organizatat Ndërkombëtare Ndërqeveritare do të përjashohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.
- 2.3 Në lidhje me nenin 11(c) të Rregullores, tatimi mbi vlerën e shtuar nuk do të aplikohet në importet apo Hyrjet nga RFJ të kryera nga UNMIK-u apo nëpërmjet UNMIK-ut për Ministrinë dhe Departamentet (Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse) dhe Drejtoratet e Administrimit të Përkohshëm në mbështetje të programeve humanitare dhe rindërtuese nëse importet dhe Hyrjet nga RFJ janë kryer nga fondet e donacioneve të dhëna nga qeveritë, agjensitë qeveritare, organizatat qeveritare dhe joqeveritare.
- 2.4 Përfaqësuesit e organizatave të shënuara në paragrafet e sipërme 2.2 dhe 2.3 që kërkojnë të çdoganojnë mallrat në Pikat Kaluese Kufitare apo Linjat Administrative Kufitare do të përgatisin për Shërbimin Doganor, në formën e pranueshme për Shërbimin Doganor, dokumentin që vërteton se ngarkesa e mallrave është e lejuar për një blerje të tillë të përjashuar.
- 2.5 Sa herë të jetë kryer një blerje e përjashuar brenda vendit nga një organizatë e shënuar në paragrafet e sipërme 2.2 dhe 2.3, përfaqësuesi i saj do të sigurojë shitësin e regjistruar me detajet identifikuese personale të tij/saj dhe një autorizim nga organizata se ai/ajo është i autorizuar të ekzekutojë blerjen zyrtare. Përfaqësuesi do të nënshkruajë faturën tatimore të përgatitur nga shitësi i regjistruar duke verifikuar se nuk është paguar TVSH për atë furnizim. Fatura tatimore do të përgatitet në dy kopje. Origjinali do t’i jepet blerësit dhe kopja e dytë do të mbahet nga shitësi i regjistruar. Blerësi do të bëjë një fotokopje të faturës tatimore, të vërtetojë origjinalitetin e saj dhe ta dërgojë në Zyren Tatimore Regjionale apo Lokale.

Neni 3 Furnizim i përjashtuar

Në lidhje me Nenin 1.9 të Rregullores, “Furnizim i Përrjashtuar” nënkupton çdo furnizim të mallrave dhe shërbimeve që nuk i nënshtrohet TVSH-së. Kjo nënkupton se Personi i Regjistruar nuk do të ngarkojë dhe mbledhë TVSH-në për atë furnizim. Në këtë rast nuk është i lejuar kurrëfarë kreditimi (zbritje) e tatimit të zbritshëm.

Neni 4 Shërbimet Financiare

Në lidhje me Nenin 1.11 të Rregullores, definicioni “Shërbimet Financiare” në 1.11(f) përfshin vetëm sigurimin jetësor dhe risigurimin. Furnizimi me Kontratat e Sigurimit te Autopergjegjesise ndaj Palës së Tretë dhe të gjitha kontratat e tjera të sigurimit të pasurisë nga kompanitë e sigurimit të regjistruara për TVSH si rrjedhim nuk janë furnizim i përjashtuar sipas nenit 12 të rregullores së TVSH-së dhe TVSH do të aplikohet (ngarkohet) në policat faturore të sigurimit. Polica faturore do të konsiderohet si faturë tatimore.

Neni 5 Person i Lidhur

Në lidhje me Nenin 1.21 të Rregullores, ‘Person i Lidhur’ do të konsiderohet një person me cilësi speciale në lidhje me personin e tatueshëm. Personat do të gjykohen të jenë të lidhur vetëm nëse:

- (a) ata janë nëpunës apo drejtorë të një biznesi tjetër;
- (b) ata janë partnerë të njohur ligjrisht në biznes;
- (c) ata janë punëdhënës dhe punëtor;
- (d) një person drejtpërdrejt apo indirekt ka, kontrollon apo mban 5 përqind apo më tepër të aksioneve ose të drejtave të votes ;
- (e) njëri prej tyre drejtpërdrejt apo indirekt kontrollon tjetrin;
- (f) të dy janë drejtpërdrejt apo indirekt të kontrolluar nga personi i tretë;
- (g) së bashku ata drejtpërdrejt apo indirekt kontrollojnë personin e tretë;apo
- (h) ata janë anëtar të familjes së njëjtë.

Neni 6 Qarkullim

Në lidhje me Nenin 1.29 të Rregullores, “Qarkullim” nënkupton te hyrat bruto të të gjitha furnizimeve të kryera nga një person në Kosovë. Përfshin furnizimet e tatueshme me përqindje tatimore normale 15%, furnizimet e tatueshme me përqindje prej 0%, blerjet e përjashtuara dhe furnizimet e përjashtuara. Qarkullimi që do të llogaritet për qëllime të regjistrimit do të jetë qarkullimi i vitit kalendarik.

Neni 7 Regjistrim

7.1 Të gjithë personat e tatueshëm të cilët importojnë, eksportojnë, kryejnë Hyrje nga RFJ apo Dalje drejt RFJ-së dhe personat e tatueshëm qarkullimi i të cilëve është më i lartë se 50,000 euro brenda vitit kalendarik kërkohet të regjistrohen për TVSH në Administratën Tatimore.

7.2 Furnizimet (shitjet) e kryera nga personat e tatueshëm të cilët importojnë apo kryejnë Hyrje nga RFJ por qarkullimi vjetor i të cilëve nuk tejkalon limitin 50,000 euro janë furnizime (shitje) të përjashtuara për nenin 12 (e) të Rregullores. Personat e tatueshëm të cilët i kryejnë këto furnizime kërkohet të regjistrohen sipas nenit 3.6 të Rregullores dhe të paguajnë TVSH-në në importet dhe Hyrjet nga RFJ. Ata nuk lejohen të ngarkojnë TVSH-në dhe nuk lejohen për zbritje të tatimit të zbritshëm. Neni 17 i Rregullores që ka të bëjë me këta persona të tatueshëm kërkon

të dorëzojnë deklaratën. Megjithatë, meqë nuk ka për të deklaruar tatim të llogaritur apo tatim të zbritshëm, Administrata Tatimore nuk do të insistojë të dorezohet deklarata tatimore.

7.3 Personat e tatueshëm të cilët janë të përfshirë në veprimtaritë e eksportit apo Dalje drejt RFJ-së dhe kërkohen të regjistrohen sipas nenit 3.5 të Rregullores do të gjykohe të kryejnë furnizime të tatueshmë 0% në eksportet e tyre apo Daljet drejt RFJ-së. Personave e tillë u lejohet zbritje e tatimit të zbritshëm dhe nga ata kërkohet të deklarojnë deklaratën tatimore mujore.

Neni 8

Procedura për t'u regjistruar

8.1 Në lidhje me Nenin 4 të Rregullores "Procedura për t'u regjistruar", personin i cili këkohet të regjistrohet duhet të bëjë një kërkesë për regjistrim në formatin e kërkuar.

8.2 Personat e tatueshëm të cilët i plotësojnë kriteret e regjistrimit kur të hyjë rregullorja e TVSH-së në fuqi kërkohet të regjistrohen mbrenda 30 ditëve pas asaj date. Rregullorja e TVSH-së ka hyrë në fuqi më 31 Maj 2001.

8.3 Personat e tatueshëm të cilët i plotësojnë kriteret për regjistrim kur rregullorja e TVSH-së të hyjë në fuqi dhe nuk janë të regjistruar deri më 1 Korrik 2001, do të regjistrohen. Mos regjistrimi vullnetar më apo para datës së kërkuar do të pasojë me gjobë.

8.4 Personat e tatueshëm të cilët nuk i plotësojnë kriteret e regjistrimit kur të hyjë në fuqi Rregullorja e TVSH-së do të kërkohet të regjistrohen mbrenda 15 ditëve pas ditës kur ata i plotësojnë kriteret. Mosregjistrimi më apo para datës së kërkuar do të pasojë me gjobë.

8.5 Aplikacioni (kërkesa) për regjistrim do të bëhet në formën të siguruar nga Administrata Tatimore dhe të dorezohet në Zyren Tatimore Regjionale apo Lokale të kërkuesit. Forma e Aplikacionit të TVSH-së duket si vijon:



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
 INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
 MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
 MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



FORMULAR REGJISTRIMI PËR TVSH

(Të dorëzohet në Administratën Tatimore)

Dokumenti No

(Përdoret vetem nga Administrata Tatimore)

Numri i Regjistrimit të Biznesit: (NRB) (1)

Emri i shkurtër i biznesit (2):

Emri i plotë i biznesit (3):

Adresa e biznesit (4):

Rruga

Numri i rrugës

Telefoni

Vendi

Komuna

Pronari/Drejtori (5)

Telefoni

(6) Qellimi i regjistrimit për TVSH

(Vendos një X)

- Deklarues i TVSH (Qarkullimi mbi 50 000 € në vit)
- Exportues
- Importues i vogël (importe, Hyrje nga RFJ por qarkullimi < 50 000 € në vit)
- Deklarues Vullnetar
- OJQ
- Zyra të ndërlidhjes
- Trup i UMMIK
- Organizatat ndër-qeveritare Internacionale
- Vullnetar deklarues

(7) Qarkullimi

Viti

Qarkullimi

Vitin e kaluar

| | |
|----------------------|----------------------|
| <input type="text"/> | <input type="text"/> |
|----------------------|----------------------|

Kete vit

| | |
|----------------------|----------------------|
| <input type="text"/> | <input type="text"/> |
|----------------------|----------------------|

(8) Dëshironi ndonjë vizitë edukative për

Po

Jo

Data e arritjes së limitit për deklarues _ / _ / _

(9) A operon biznesi juaj në më shumë se një adresë?

Po

Shto listën e adresave në faqen pas

Jo

10. Deklarata e pronarit /Drejtorit:

Unë, Deklaroj me përgjegjësi që informacioni i paraqitur më sipër është i saktë dhe i plot dhe unë aplikoj për regjistrim për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

.....
 Nënshkrimi i pronarit/Drejtorit

...../...../.....
 Data

Vetem për përdorim zyrtar

1./Për zyra qëndrore

Shëno Adresën dhe telefonin për secilin lokacion ku biznesi juaj operon:

| <u>Numri i regjistrimit të biznesit</u> | <u>Rruga</u> | <u>Nr</u> | <u>Vendi</u> | <u>Komuna</u> | <u>Telefoni</u> |
|---|--------------|-----------|--------------|---------------|-----------------|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |


Udhëzime

1. Vendose Numrin e regjistrimit të biznesit
2. Trego emrin e shkurtër të biznesit tuaj
3. Trego emrin e plotë të biznesit tuaj
4. Shëno adresën e biznesit tuaj
5. Trego emrin e pronarit/Drejtorit
6. Trego qëllimin për regjistrimin e TVSH. Zgjidhe statusin e përshtatshëm
7. Në numrin 7 trego qarkullimin total të biznesit tuaj për vitin e kaluar dhe për këtë vit
8. Trego nëse dëshiron që biznesi juaj të vizitohet nga zyrtaret e Administratës Tatimore, të sqarojnë për obligimet që keni për tatimin mbi vlerën e shtuar
9. Trego nëse biznesi juaj operon në më tepër vende. Ju duhet të tregoni adresat e sakta për secilin vend shtesë të biznesit në hapsirën e përmby Udhezime.
10. Aplikacioni duhet nënshkruar dhe vendosur datën në numrin 10 nga aplikanti. Nënshkruesi deklaron se shënimet e cekura më lart janë të sakta dhe korrekte.

Çertifikata regjistruese e TVSH do të lëshohet duke i paraqitur emrin e biznesit, numrin regjitrues të biznesit dhe adresën themelore të biznesit. Çertifikata regjistruese e TVSH duhet të paraqitet publikisht në këtë lokacion. Çertifikatat shtesë të TVSH do të lëshohen për secilin adresë shtesë të biznesit. Nëse më vonë ndonje nga këto detaje ndryshohet, ose aktiviteti i biznesit shuhet në lokacionin e paraqitur, çertifikata regjistruese e TVSH duhet ti kthehet Administratës Tatimore. Të gjitha çertifikatat e TVSH mbasin pronë e Administratës Tatimore.


NRB duhet të tregohet në të gjitha faturat dhe dokumentet e Administratës Tatimore dhe Departamentit të Doganave

8.6 Kur të jetë kompletuar aplikacioni dhe procesi i regjistrimit, Administrata Tatimore do të lëshojë Çertifikatën e Regjistrimit të TVSH-së në të cilën vendoset numri unik identifikues i TVSH-së. Aplikuesi do të ketë po aq çertifikata sa edhe numri i vendeve të deklaruara të biznesit dhe secila çertifikatë do të ketë numrin identifikues të njëjtë. Çertifikata e Regjistrimit të TVSH-së duket si vijon:



EUROPEAN UNION

Autoriteti Qendror Fiskal
Central Fiscal Authority



United Nations Mission Administration Mission in Kosovo

ÇERTIFIKATE REGJISTRIMI PER TVSH

**NUMRI
CERTIFIKATES:**

Kjo Certifikatë i lëshohet nga Administrata Tatimore e A27:

Me Numër të Përkohshëm të Regjistrimit të Bëgnetit (MPRB):

në adresën e mëposhtme të bëgnetit:

Kjo Certifikatë duhet mbajtur në vendin e bëgnetit në adresën e mësipërme. MPRB duhet vendosur në të gjitha dokumentet dhe korespondencën me Administratën Tatimore dhe Doganore.

Data e Lëshimit:

Kjo Certifikatë mbetet pronë e Administratës Tatimore të AQF. Nëse ndodh ndryshim apo detyrimi për të qenë i regjistruar për TVSH ndërprerët, Certifikata e Regjistrimit për TVSH duhet t'i rikthehet Administratës Tatimore

8.7 në lidhje me nenin 25 të Rregullores “Detyrimi për të informuar rreth ndryshimeve”, aty ku shfaqen ndryshimet në lidhje me të dhënat të vëna në formularin e aplikacionit të regjistrimit, personi i tatueshëm ka për obligim të njoftojë Administratën Tatimore mbrenda 15 ditëve për ndryshimet duke plotësuar një Amandament (Ndryshim) në formularin e Regjistrimit që duhet të mbushet në Zyren Tatimore Regjionale apo Lokale të tatimpaguesit. Forma e Amandamentit të formularit të Regjistrimit duket si vijon:



EUROPEAN UNION

Autoriteti Qendror Fiskal

Central Fiscal Authority

UNMIK



United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

Dokument Nr..
Përdoret vetëm nga Administrata Tatimore

FORMULAR NDRYSHIMESH PER
REGJISTRIMIN NE TVSH

1. Numri Identifikues i Biznesit (NIT)

2. Modifikim për emrin e biznesit

Emri i ri i shkurtër i biznesit:

Emri i ri i gjatë i biznesit:

3. Modifikim për statutin e TVSH (ju lutëm vendos një "X"):

Nga importues vogel ne deklarues TVSH (qarkullimi > 200000 DM) Nga deklarues i TVSH (qarkullimi > 200000 DM) në importues të vogël

Nga importues i vogel ne expotues

Nga exportues në Importues të vegjël

Nga exportues ne deklarues i TVSH (qarkullimi . 200000 DM)

Nga deklarues i TVSH (qarkullimi > 200000 DM) në exportues

4. A është ndërprerë obligimi për TVSH PËRGJITHMONË ?

Po Vendos datën & arsyen kur është ndërprerë obligimi:

Transferuar/shitur nga:

Mbyllur

Tjera:

5. Modifikimi i tanishëm për Adresën & numrin e telefonit të biznesit:

Adresa e Biznesit të ri:

Rruga

Numri i rrugës

Vendi

Komuna

Telefoni

6. Deklaruar nga Drejtori/Pronari:

Unë, deklaroj me përgjegjësi se të dhënat e më lartëshënuara janë te sakta dhe korrekte.

Data e ndryshimit / /

7. Nëse biznesi juaj operon në më tepër se një adresë, dhe ndodh ndonjë ndërrim i këtyre adresave apo biznesi juaj tani operon nga lokacioni i ri apo biznesi juaj pushon se vepruari në adresën ekzistuese, ju lutem shënoni detajet. Numri i certifikates të biznesit ekzistues duhet të plotësohet.

| Kodi | Nr.regj.i njesis | Rruga | Nr. | Vendi | Komuna | NIT i Certifikatës |
|------|------------------|-------|-----|-------|--------|--------------------|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

Vërejtje:

Codi "A" shtoi adresën e re ku udhëhiqet biznesi

Code "C" fshij adresën ekzistuese ku biznesi është udhëhequr më par

Neni 9
Vlera e Tatueshme

- 9.1 Në lidhje me nenin 8.4 të Rregullores, metoda kryesore për percaktimin e Vlerës së Hapur të Tregut do të jetë vlera e mallrave dhe shërbimeve të ngjashme e sasisë dhe cilësisë së njëjtë që i shiten blerësit i cili është tërësisht i pavarur nga shitësi në një transaksion të tregut të hapur. Aty ku nuk ka mallra dhe shërbime të ngjashme në dispozicion në tregun e hapur, vlera e hapur e tregut do të jetë Metoda e Kostos Plus që është kostoja e prodhimit të mallrave apo kryerjes së shërbimit plus marzha e fitimit që aplikohet për atë lloj të biznesit.
- 9.2 Në lidhje me nenin 8.6 të Rregullores, aty ku shuma e TVSH-së nuk është listuar ndarazi në faturën tatimore, TVSH-ja për atë furnizim do të llogaritet duke pjesëtuar vlerën totale me 7.666. Ndryshimi në mes të çmimit përfshirës të tatimit të vlerës së shtuar dhe TVSH-së do të jetë vlera e tatueshme. Për shembull, nëse çmimi i mallit i vendosur në vitrinën e shitores është 115 euro përfshirë TVSH-në, mund të gjejmë shumën e TVSH-së për atë furnizim duke pjesëtuar 115 me 7.666 që na jep 15 euro. Vlera e tatueshme është 100 euro, kështu $115 - 15 = 100$.

Neni 10
Prova dokumentare për Eksport dhe Dalje drejt RFJ-së

- 10.1 Në lidhje me Nenin 10.2 të Rregullores, prova dokumentare që kërkohet për të vërtetuar se një eksport ka ndodhur do të jetë Dokumenti Administrativ i Unifikuar i Doganës dhe kopja e deklaratës së importit e vendit pranues.
- 10.2 Në lidhje me Daljen drejt RFJ-së, prova dokumentare që kërkohet për të vërtetuar se një Dalje drejt RFJ-së ka ndodhur do të jetë Dokumenti Administrativ i Unifikuar i Doganës.

Neni 11
Rikthimet

- 11.1 Një kontraktor i cili kryen furnizime për personat e përjashuar të listuar në nenin 13.2(a) të Rregullores dhe i cili poashtu kryen furnizime të tatueshme për personat tjerë do të kërkohet të përcaktojë pjesën e saktë të importeve dhe Hyrjeve nga RFJ të atribuara për furnizimet e pranueshme për rikthim sipas nenit 13.1
- 11.2 Në lidhje me Nenin 13.2(a) të Rregullores, prova dokumentare që kontraktori kërkohet të ketë për të vërtetuar se është i titulluar për rikthim do të jetë kopja e kontratës me UNMIK-un, agjensionet e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, Bankën Botërore dhe Organizatat Ndërkombëtare Ndërqeveritare dhe një letër nga autoriteti përkatës që specifikon se importi apo Hyrja nga RFJ është për atë kontratë specifike. Poashtu kërkohet një kopje autentike e Deklaratës Doganore duke vërtetuar se TVSH-ja është paguar në import apo Hyrje nga RFJ.
- 11.3 Në lidhje me Nenin 13.2(b) të Rregullores, prova dokumentare që kërkohet nga Organizata Joqeveritare për të vërtetuar se është e titulluar për rikthim do të jetë çfarëdo dokumenti që vërteton se mallrat e sjellura në Kosovë janë shfrytëzuar ekskluzivisht për qëllime bamirëse apo për përfitim publik. Dokument mund të jetë lista e përfituesve dhe nënshkrimet e tyre; deklaratat nga komunat apo organizatat tjera bamirëse; deklarata nga përfituesi; dokument tjetër i ngjashëm. Organizata Joqeveritare duhet poashtu të sigurojë kopjen autentike të

Deklaratës Doganore që vërteton se TVSH-ja është paguar në importet apo Hyrjet nëpërmjet RFJ-së.

11.4 Kërkesat e rikthimit nuk do të bëhen më shpesh se një herë në muaj. Administrata Tatimore do të shqyrtojë të gjitha vërtetimet e siguruara nga kërkuesi dhe mund të kërkojë vërtetim shtesë nëse konsiderohet e nevojshme. Kërkesat e rikthimit do të futen në proces në afatin e duhur dhe Administrata Tatimore do të përgjigjet me shkrim për miratimin apo refuzimin e rikthimit. Aplikacioni i rikthimit do të dorëzohet në Zyren Tatimore Regjionale apo Lokale të kërkuesit. Një ekzemplar i aplikacionit është paraqitur në nenin 18 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 12
Fatura Tatimore

12. 1 Në lidhje me Nenin 14 të Rregullores, forma e Faturës Tatimore është si vijon:

| Fatura Tatimore | | | | | | | |
|---|-----------------------------------|---|-------|---|---------------|--|-----------------------------|
| | | | | | | Numri serik <input style="width: 100px;" type="text"/> | |
| | | | | | | Data/Muaji/Viti ____/____/____ | |
| Emri i shitësit | | <input style="width: 100%;" type="text"/> | | | | | |
| Numri ID i TVSh së shitësit | | <input style="width: 100%;" type="text"/> | | | | | |
| Adresa e shitësit | | <input style="width: 100%;" type="text"/> | | | | | |
| Numri i tel. | | <input style="width: 100%;" type="text"/> | | | | | |
| Emri i blerësit | | <input style="width: 100%;" type="text"/> | | | | | |
| Numri ID i TVSh së Blerësit(nëse ka) | | <input style="width: 100%;" type="text"/> | | | | | |
| Adresa e blerësit | | <input style="width: 100%;" type="text"/> | | | | | |
| Numri i tel. | | <input style="width: 100%;" type="text"/> | | | | | |
| Nr. | Përshkrimi i mallit apo shërbimit | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSh | Vlera pa TVSh | TVSh | Vlera totale përfshirë TVSh |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6=4x5 | 7=6x15% | 8=6+7 |
| | | | | | | | |
| GJITHSEJT | | | | | | | |
| Furnizimet e tatueshme | | | | | | | |
| Furnizimet me 0% | | | | | | | |
| Furnizimet me 15% | | | | | | | |
| Furnizimet e perjashtuara | | | | | | | |
| Emri dhe nënshkrimi i blerësit (_____) | | | | Emri, nënshkrimi dhe vula e shitësit (_____) | | | |

12.2 Një faturë lëshohet çdo herë që personi i regjistruar i bën një furnizim të tatueshëm biznesit tjetër apo konsumatorit final. Fatura duhet të lëshohet në së paku dy kopje autentike, një për shitësin dhe një për blerësin. Në qoftë se personi i regjistruar është duke shfrytëzuar kasën regjistruese, kuponi elektronik duhet të përmbajë së paku të dhënat vijuese:

- Numrin ID të TVSH-së dhe Emrin e shitësit
- Datën dhe Numrin serik
- Çmimin pa TVSH
- TVSH-në
- Çmimin e përgjithshëm (totalin)

Në fund të ditës, një fature tatimore permbledhese duhet të përgatitet duke bere shumen e te gjithë kuponave elektronike të lëshuar gjatë ditës dhe duke paraqitur shumat totale. Dokumentacioni mbështetës duhet të ruhet për t'u ekzaminuar nga Administrata Tatimore. Të dhënat në faturën tatimore do të regjistrohen në librin e shitjes në mënyrë të njëjtë si për të gjitha faturat e tjera të tatimore. Kuponi nuk do të njihet si dokument zyrtar për zbritjen e tatimit të zbritshëm.

Neni 13 Rregullimet

Në lidhje me Nenin 15 të Rregullores, një notë Krediti apo Debiti lëshohet nga personi i tatueshëm çdo herë pasi të jetë lëshuar fatura tatimore dhe TVSh-ja e ngarkuar tejkalon apo është më pak se sa TVSh-ja aktuale për atë furnizim. Nota e Kreditit apo Debitit është e përgatitur në formatin e njëjtë sikurse Fatura Tatimore origjinale dhe duhet të përmbajnë numrin serik që ka të bëjë me faturën origjinale, shumën e rishikuar të furnizimit, shumën e rishikuar të tatimit, arsyen e bërjes së këtij rregullimi dhe fjalët 'Notë Krediti' apo 'Notë Debiti', me dorëshkrim, në këndin në anën e sipërme të djathtë të faturës.

Neni 14 Deklarimi dhe Pagesa

14.1 Në lidhje me Nenin 17 të Rregullores forma e Deklaratës së TVSH-së është si vijon:



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TVSH

[1] Periudha tatimore [2] Numri serik

[3] Numri i Regjistrimit të Biznesit [4] Numri i perkohshem tatimor

[5] Emri i biznesit

[6] Adresa e re e biznesit
(Nese eshte ndryshuar adresa nga deklarimi i fundit) Telefoni

[7] Emri i pronarit Telefoni

[8a] Vendosni 'X' këtu nëse nuk ka ndodhur asnjë transacion gjatë periudhës së kaluar tatimore. Vetëm nënshkruani dhe dorëzoni deklaratën në bankën e autorizuar.

[8b] Vendosni 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzoni për herë të parë në këtë periudhë tatimore

Shtesë

Korigjim

Pagesë shtesë

TVSh e llogaritur për muajin

- [9] Furnizimet(shitjet) e përjashtuara
[10] Furnizimet(shitjet) e imputeve bujqesore me 0%
[11] Eksportet dhe furnizimet e tatueshme me 0%
[12] Shitjet e tatueshme në normën normale 15%

| Vlera e tatueshme | TVSh e llogaritur |
|-------------------|-------------------|
| [9] | |
| [10] | |
| [11] | |
| [12] | [13] |

TVSh e zbritshme për muajin

- [14] Blerjet e përjashtuara dhe me TVSH jo te zbritshme
[15] Blerjet e imputeve bujqësore te tatueshme me 0%
[16] Importet dhe Hyrjet nga RFJ
[18] Blerjet e tatueshme vendore me 15%

| Vlera e tatueshme | TVSh e zbritshme |
|-------------------|------------------|
| [14] | |
| [15] | |
| [16] | [17] |
| [18] | [19] |

Rregullimet

- [20] Teprica e TVSh e bartur nga muaji i kaluar
[21] Kërkesa për rimbursim nga tatimi i paguar tepër
[22] Balansi kreditor nga muaji i kaluar [20]-[21]
[23] Balansa kreditore e përgjithshme për muajin [23]=[17]+[19]+[22]
[24] Balansa kreditore e mbetur[24]=[23]-[13] nëse [23]>[13] (dërgoje në kutinë [20] të deklaratës tatimore të muajit të ardhshëm)
[25] TVSh që duhet paguar [25]=[13]-[23]nëse [13]>[23]
[26] Ndëshkimet për deklarim dhe pagesë të vonuar
[27] Obligimi i përgjithshëm që duhet paguar [25]+[26]
[28] Shuma e paraqitur për pagesë

| Balansi kreditor i TVSh | |
|-------------------------|------|
| [20] | |
| [21] | |
| | [22] |
| | [23] |
| [24] | |
| | [25] |
| | [26] |
| | [27] |
| | [28] |

Deklaroj se informatat e përfshira janë të sakta.

Emri dhe nënshkrimi

(_____)

dd/mm/vv

__/__/__

Pjesa e pagesës së Bankes

Informatat bankare të pagesës

| Numri i llogarisë: 1000420070000373 | Dega/Referenca e transferit | Nr | Euro | Vlera |
|--|-----------------------------|----|-----------|-------|
| Mbajtësi i llogarisë/Buxheti i Konsoliduar i Kosovës | Data/Nënshkrimi/Vula | | 500 | |
| | | | 200 | |
| Valuta | Shuma | | 100 | |
| Ref. e klientit. | Data e vlerës | | 50 | |
| Teksti | | | 20 | |
| | | | 10 | |
| | | | 2 | |
| | | | 1 | |
| | | | Euro cent | |

Nr.Formës TV-A-2; Korigjuar më 01.09.2004

- 14.2 Deklarata tatimore duhet të dorëzohet në çdo bankë të autorizuar në Kosovë, së bashku me pagesën, më ose para ditës së fundit e muajit vijues të periudhës tatimore. Deklarata tatimore do të përgatitet në tri kopje autentike: e para i përket Administratës Tatimore, e dyta bankës dhe e treta tatimpaguesit.
- 14.3 Aty ku afati i fundit i deklaramit për deklaratën e TVSH-së është e Dielë apo Festë Kombëtare, deklarata do të dorëzohet në ditën e parë punuese që pason të Dielën apo Festën Kombëtare.

Neni 15 Mjetet Kryesore

- 15.1 Në lidhje me Nenin 18.2 të Rregullores, shtyrja e afatit të TVSH-së në Mjetet Kryesore do të lejohet vetëm për bizneset e sapo themeluara, në importin apo Hyrjen nga RFJ të makinerisë dhe pajisjes që bien nën Kapitujt 84 dhe 87 të Nomenklaturës së Harmonizuar të Sistemit të Mallrave. Makineria dhe pajisja mund të jenë të reja apo të përdorura dhe do të shfrytëzohen për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve tjera.
- 15.2 Më qëllim të përfitimit nga kjo shtyerje bizneset e reja do të kërkojnë nga Administrata Tatimore duke e mbushur një formular aplikacioni. Aplikuesi duhet t'ia bashkangjesë aplikacionit kopjen e planit të biznesit, kopjen e kontratës me shitësin e makinerisë apo pajisjes, garancionin bankar për të mbuluar pjesën e TVSH-së, një plan të uzinës apo fabrikës, lejen e ndërtimit të dhënë nga agjensitë e autorizuar.
- 15.3 Administrata Tatimore do të shqyrtojë kërkesat dhe do t'u dhurojë shtyrje të afatit aplikantëve të cilët përmbushin kushtet e besueshmërisë. Miratimi apo refuzimi të bëra me shkrim do t'i lëshohen nga Administrata Tatimore aplikantit dhe një kopje do t'i dorëzohet Shërbimit Doganor përpara se importimi apo Hyrja nga RFJ të bëhet. Biznesi i ri do t'i japë njoftim paraprak Shërbimit Doganor të datës që parashihet dhe vendit të hyrjes së mallrave në Kosovë. Në kohën e importimit/Hyrjes, Shërbimi Doganor do të kërkojë nga pronari i mallrave letrën e miratimit të lëshuar nga Administrata Tatimore dhe të verifikojë se korrespondon me letrën e miratimit të dërguar përpara Doganës nga Administrata Tatimore. Shërbimi Doganor do të llogarisë shumën e shtyrë të TVSH-së për mjetin kryesor dhe të shkruajë "E Shtyrë" pranë shumës së TVSH-së në Deklaratën Doganore. Shërbimi Doganor do të njoftojë Administratën Tatimore për shtyrjen (e afatit) në kohën e arritjes.
- 15.4 Personi i tatueshëm ka 6 muaj të kompensojë TVSH-në ndaj tatimit të llogaritur. Nëse gjatë periudhës gjashtëmujore personi i tatueshëm fillon të furnizojë mallrat dhe shërbimet e tatueshme, personi i tatueshëm do të përgatisë faturën tatimore me vlerën e mjetit kryesor dhe tatimin mbi vlerën e shtuar përkatës. Të dhënat në faturën tatimore do të korrespondojnë me të dhënat në deklaratën doganore. Të dhënat e faturës tatimore do të regjistrohen në dy librat si të shitjes ashtu edhe të blerjes, duke bërë zero TVSH-në për mjetin kryesor dhe TVSH-ja e llogaritur që është ngarkuar dhe mbledhur nga blerësit do të derdhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (pas zbritjes së ndonjë TVSH-je të zbritshme potenciale në blerjet e tjera).
- 15.5 Në qoftë se në fund të periudhës 6 mujore tatimi mbi vlerën e shtuar nuk është paguar, Administrata Tatimore do të kërkojë nga banka të mbulojë ndryshimin nga garancioni. Kurrëfarë krediti i tatimit të zbritshëm nuk do të lejohet derisa përfituesi i shtyrjes së afatit të fillojë furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të tatueshme.

Neni 16
TVSH-ja e pazbritshme

Në lidhje me Nenin 21.2 të Rregullores, ulja nga TVSH-ja nuk do të lejohet në rastet vijuese:

- a) Blerja e karburanteve, përveç kur:
 - i) Fushë-veprimi i aktivitetit është tregtia e karburanteve,
 - ii) Karburanti është i domosdoshëm për nevoja teknologjike të aktivitetit, sikurse është rasti i karburantit për një kompani transporti, karburanti për nxëmjen qendrore, karburanti për kamionin e shpërndarës;
- b) Shpenzimet e udhëtimit, përfaqësimit, qirasë, ushqimeve dhe zbavitjes
- c) Shpenzimet lidhur me veturat, përveç kur,
 - i) Fushë-veprimi i aktivitetit është tregtia e veturave
 - ii) Përdorimi i veturave është aktivitet i vetëm i personit të tatueshëm, sikurse është rasti i shërbimeve të Dhënies me Qira të Veturave, Shërbimet e Taksive, Shërbimet e Ambulancës dhe Shërbimet e Varrimit.
- d) Të gjitha shërbimet lidhur me shpenzimet e listuara nga 'a' deri 'c'.

Neni 17
Borxhi i keq

17.1 Në lidhje me nenin 22 të Rregullores, një borxh konsiderohet "Borxh i Keq" kur të jenë paraqitur kushtet vijuese:

- Tërë ose pjesë e pagesës për furnizimin e tatueshëm nuk është marrë nga furnizuesi,
- Kanë kaluar së paku gjashtë muaj pas periudhës tatimore për të cilën është ngarkuar TVSH-ja në lidhje me atë furnizim,
- Personi i tatueshëm mund të vërtetojë se të gjithë hapat ligjor janë ndërmarrë për të mbledhur (arkëtuar) atë borxh përpara se fatura për borxh të keq të jetë lëshuar dhe duhet të ketë evidenca për këtë efekt. Evidenca e tillë do të përfshijë vendimin të dhënë nga Gjyqi në Kosovë në lidhje me borxhin në mënyrë që të mbulohet apo deklarata nga Zyra e Prokurorit, CIVPOL-I, Shërbimi Policor i Kosovës apo Autoritetet Komunale në lidhje me borxhliun ose evidenca të forta të pranueshme nga Administrata Tatimore.

17.2 Në qoftë se të tri kushtet plotësohen, shitësi duhet të lëshojë një faturë për borxh të keq i cili është i përgatitur në format të njëjtë si një faturë normale. Fatura e tillë duhet të përmbajë fjalët "Fatura e Borxhit të Keq" dhe duhet t'i referohet numrit serik të faturës origjinale për të cilën pagesa apo pjesë e pagesës nuk është marrë. Kjo faturë pastaj shfrytëzohet nga shitësi i regjistruar për të zvogëluar TVSH e llogaritur dhe nga blerësi i regjistruar për të zvogëluar zbritjen e tatimit të zbritshëm. Libri i Shitjes i shitësit të regjistruar dhe Libri i Blerjes i blerësit të regjistruar duhet të plotësohen varesisht prej kesaj fature.

Neni 18
Rimbursimet

18.1 Në lidhje me nenin 23 të Rregullores, "Tatimi i paguar tepër dhe Rimbursimi", në qoftë se balansi i tatimit të paguar tepër, sipas kutisë [18] të deklaratës tatimore është bartur për së paku 6 muaj dhe shuma e mbartur tejkalon 5,000 euro, personit të tatueshëm i lejohet të kërkojë rimbursim.

18.2 Për eksportuesit dhe ata të cilët kryejnë Dalje drejt RFJ-së, rimbursimi mund të kërkohet çdo tremujor apo çdo muaj nëse shuma e tatimit të tejkalar është më e lartë se 5,000 euro.

18.3 Aplikacionet për rimbursim do të pranohen nga Administrata Tatimore duke filluar nga Janari 2002. Forma e Aplikacioni për Rimbursim duket si vijon:



Autoriteti Qendror Fiskal
Central Fiscal Authority



KËRKESË PËR RIMBURSIM DHE RIKTHIM

Numri i Regjistrimit të Biznesit (1)

Dokumenti numër
(Vetëm për përdorim zyrtar)

Emri i shkurtër i biznesit (3):

Adresa e biznesit (5):

Rruga

Numri i rrugës

Telefoni

Vendi

Komuna

Pronari/Drejtori (6):

Telefoni

A. RIMBURSIMI I KËRKUAR

Unë dëshiroj të aplikoj për rimbursim të TVSH kreditore të paraqitur në kutinë 19 të deklaratës së TVSH për muajt:

Periodha tatimore

Vlerësimi numër

(Përdoret vetëm nga Administrata Tatimore)

Shuma e rimbursimit duhet të transferohet ose rimbursohet në përputhje me preferencat e paraqitura më poshtë, megjithëse unë pranoj që një pjesë apo i tërë rimbursimi të përdoret për të përmbushur ndonjë detyrim timin ndaj Zyrës Tatimore.

Nënshkrimi i tatimpaguesit

data

I kontrolluar & Autorizuar nga:
(Përdoret vetëm nga zyra tatimore)

19. Rimbursimi i kërkuar në kutinë 19 të Deklaratës së TVSH
Si duhet bërë rimbursimi:

(30) Transferojë për ndonjë obligim tjetër tatimor:

| | | |
|--------|------------------|------------------|
| Tatimi | Perioda tatimore | Numri vlerësuesi |
|--------|------------------|------------------|

(31) Transferojë për ndonjë obligim tjetër tatimor:

| | | |
|--------|------------------|------------------|
| Tatimi | Perioda tatimore | Numri vlerësuesi |
|--------|------------------|------------------|

(32) Transferojë për ndonjë obligim tjetër tatimor:

| | | |
|--------|------------------|------------------|
| Tatimi | Perioda tatimore | Numri vlerësuesi |
|--------|------------------|------------------|

(Kodi i llojit tatimor: 0-TVSH, 1- Tatimi i paragjykuar, 2-tatimi në fitim, 3-H&R)

(33) Totali i transferit ((30) + (31) + (32)):

(34) Balanci që duhet rimbursuar ((19) - (33)):

| Tatimpaguesi | Përdoret vetëm nga Administrata tatimore |
|--------------|--|
| (19) | |
| (19) | |
| (19) | |
| (19) | |
| (19) | |
| (19) | |

B. RIKTHIMI I KËRKUAR

Perioda tatimore

TVSH e paguar në import
(Referensat kërkohen)

Kërkesa për Rikthim të TVSH

| Tatimpaguesi | Përdoret vetëm nga Administrata tatimore |
|--------------|--|
| | |
| | |
| | |

Nënshkrimi i tatimpaguesit

Data

E kontrolluar & Autorizuar nga:

Banka

Numri i llogarisë

Emri i inspektorit

Numri

Data e autorizimit

18.4 Administrata Tatimore do të shqyrtojë duke kontrolluar të gjitha kërkesat për rimbursim përpara se ato të futen në proces dhe do të japë rezultatet e çdo kontrolli me shkrim dhe mbrenda preiudhës së arsyeshme kohore.

Neni 19
Librat dhe Regjistrimet

19.1 Të gjitha furnizimet (shitjet) do të regjistrohen në Librin e Shitjes. Forma e Librit të Shitjes duket si vijon:

LIBRI I SHITJES

Numri identifikues i TVSh-së i Personit të tatueshëm

Faqja _____

| Fatura | | | | Shitjet Totale | Furnizimet e Përfunduar | Furnizimet e Tatueshme | | |
|--|-------|---------|--------------------------|----------------|-------------------------|--|-------------------------------|-----------|
| Data | Numri | Blerësi | NIT i blerësit (nëse ka) | | | Furnizimet me 0%, Daljet dhe Eksportet | Furnizimet e tatueshme me 15% | TVSh |
| A | b | c | d | e=f+g+h | f | g | h | i |
| | | | | | | | | |
| Gjithsej | | | | | | | | |
| Numri i kutisë në Deklaratën Tatimore | | | | | 9 | 10 | 11 | 12 |

19.2 Të gjitha blerjet do të regjistrohen në Librin e Blerjes. Forma e Librit të Blerjes duket si vijon:

LIBRI i BLERJES

FAQE _____

Numri identifikues i TVSh-së i Personit të tatueshëm

| |
|--|
| |
|--|

| Fatura | | | | Blerja totale me TVSh | Blerjet pa TVSh e me TVSh të pazbritshme | Blerjet që i nënshtrohen TVSh-së | | | |
|---------------------------------------|-------|-----------------|----------------|-----------------------|--|----------------------------------|-----------|-------------------|-----------|
| Data | Numri | Emri i Shitësit | NIT i shitësit | | | Importet | | Blerjet Vendore | |
| | | | | | | Vlera e tatueshme | TVSh | Vlera e tatueshme | TVSh |
| a | b | c | d | e | f | g | H | I | j |
| | | | | | | | | | |
| Gjithsej | | | | | | | | | |
| Numri i kutisë në Deklaratën tatimore | | | | | Kutija 13 | Kutija 14 | Kutija 15 | Kutija 16 | Kutija 17 |

19.3 Faqet e fundit të Librit të Blerjes do të jenë në disponim për regjistrim të inventarit përfundues të mallrave më 31 Dhjetor të çdo viti. Forma e faqeve të tilla është paraqitur më poshtë:

| Përshkrimi i mallrave | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSh | Gjithsej pa TVSh | TVSh e pazbritshme | Gjithsej |
|-----------------------|-------|-------------------------|------------------|--------------------|----------|
| 1 | 2 | 3 | 4=2x3 | 5 | 6=4+5 |
| | | | | | |
| | | | | | |

Neni 20
Periudha e ruajtjes se librave

Periudha e ruajtjes për librat dhe regjistrimet dhe dokumentet e tjera origjinale lidhur me to do të jetë pesë vjet.

Neni 21
Konstruksioni

Në lidhje me nenin 12 të Rregullores “Furnizim i Përjashtuar”, transferi i titullit dhe dhënia me qira e pasurisë së banueshme dhe tokës është një furnizim i liruar nga tatimi. Megjithatë ‘Konstruksioni’ konsiderohet një furnizim normal i shërbimeve dhe është furnizim i tatueshëm. Për shkak të

karakteristikave specifike të konstruksionit “Situacioni e Progresit të Punëve” do të njihet si një Faturë e Shitjes normale e TVSh-së.

Neni 22

Furnizimet për përdorim personal

Aty ku mallrat apo shërbimet janë përdorur nevoja personale të aktivitetit të tij ekonomik të personit të tatueshëm, transaksioni do të regjistrohet si vijon:

- Fatura tatimore do të lëshohet duke ngarkuar TVSh-në me normën (përqindjen) e kërkuar tatimore për atë furnizim dhe të regjistrojë faturën tatimore në Librin e Shitjes, dhe
- Fatura e njëjtë do të regjistrohet në Librin e Blerjes. Ndikimi i TVSh-së për një furnizim të tillë për vetvete është zero.

Neni 23

Pagesat në Avance

Aty ku personi i regjistruar merr një avans përpara se mallrat dhe shërbimet të jenë dërguar, fatura e tatimore do të përgatitet menjëherë nga personi i regjistruar dhe do të regjistrohet në atë kohë në Librin e Shitjes.

Neni 24

Koeficienti i Kreditimit Tatimor

Aty ku personi i regjistruar kryen furnizimet e tatueshme dhe furnizimet e përjashtuara të mallrave dhe shërbimeve, do të llogaritet Koeficienti i Kreditit Tatimor bazuar në formulën vijuese:

Furnizimet e tatueshme

Koeficienti i Kreditit Tatimor = -----

Furnizimet e tatueshme + Furnizimet e përjashtuara

Koeficienti do të llogaritet në fund të periudhës tatimore dhe do të zbatohet në TVSh-në e paguar në importet, Hyrjet nga RFJ dhe blerjet brenda vendit për atë periudhe tatimore. Rezultati do të jetë TVSH e Lejuar si Tatim i Zbritshëm për periudhën tatimore, që është i zbritshëm nga Tatimi i Llogaritur i të njëjtës periudhë.

Neni 25

Zbritja e Tatimit të Shitjes

Nuk do të lejohet asnjë zbritje tatimi ndaj TVSH-së për Tatimin në Shitje të paguar në importimin e mallrave përpara hyrjes në fuqi të Rregullores së TVSh-së madje edhe nëse tërë apo pjesë e mallrave të tilla rezultojnë si rezervë (stok) më 1 Korrik 2001.

Neni 26

Ndikimet e Tatimit të Paragjykuar dhe Tatimit në Fitim

Vlera totale e furnizimeve, si atyre të përjashtuara ashtu edhe furnizimeve të tatueshme të personit të tatueshëm që përfshijnë furnizimet e tatueshme me 0 përqind do të jetë baza e tatueshme për Tatimin e Paragjykuar apo Tatimin në Fitim për atë person të tatueshëm. TVSH-ja e aplikuar duhet

të përjashtohet nga vlera totale. Baza e tatueshme e Tatimit të Paragjykuar apo Tatimit në Fitim, apo qarkullimi, do të jetë shuma e regjistruar në shtyllën Furnizimet Totale të Librit të Shitjes për çdo tre muaj të mbuluar nga periudha e Tatimit të Paragjykuar apo Tatimit në Fitim. Personat e tatueshëm të TVSH-së të cilët kërkohet të deklarojnë TVSH, nuk kërkohet të mbajnë Librat e Shitjes dhe të Blerjes të Tatimit të Paragjykuar, duke filluar nga 1 Korriku 2001. Librat e TVSH-së do të përdoren për qëllime të Tatimit të Paragjykuar dhe Tatimit në Fitim.

Neni 27
Kundërvajtjet dhe Gjobat

Veç gjobave të vëna në nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/20 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe neni 9.2 i Udhëzimit të Administratës Tatimore Nr. 1/2000, gjobat vijuese do të zbatohen për kundërvajtjet e listuara poshtë:

- të dështuarit për të kërkuar për t'u regjistruar dhe çregjistruar – 125 euro
- të dështuarit e njoftimit të ndryshimeve – 125 euro gjobë
- të dështuarit e lëshimit të faturës tatimore kur kërkohet – vlerësimi i TVSH-së plus gjoba prej 125 euro.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi më 1 Shtator 2004 dhe e zëvendëson Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2001 i cili si rrjedhojë është tërhequr.

Ali Sadriu
Ministër i Financave dhe Ekonomisë